



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSEDNIK OPSTINE

Tel/fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n
E-mail: Info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	18.03.2026
NR/BR.	01.Nr.35
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
NGA/OD/FROM	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me Nr. 10 i datës 30.12.2025 i plotësuar-ndryshuar me Vendimin me Nr. 26 i datës 27.02.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 nenit 52. Të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 4,5 dhe 6 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë. Neni 17, paragrafi 17.1 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përmes Kuvendit të Komunës bënë këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për plotësim ndryshimin e Vendimit me Nr.10 të datës 30.12.2025 i plotësuar-ndryshuar me Vendimin me Nr. 26 i datës 27.02.2026

ARSYETIMI

Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 ka miratuar vendimin me Nr: 01.Nr.26 për plotësim ndryshimin e Vendimit me Nr.10 të datës 30.12.2025.

Mirëpo ky vendim është kontestuar si i pa ligjshëm nga ana e MAPL-së, përkatësisht me nenin 52 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe udhëzimin administrativ (MAPL) NR.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Neni 52 paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale parashihet se Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e komunës.

Ndërsa neni 5 paragrafi 1 dhe 2 i Udhëzimit Administrativ (Mapl) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komitetit të përhershëm dhe komiteteve tjera në komunë, përcakton se: “Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike në kuvendin e Komunës.

Entiteti politik me numrin më të madh të vendeve, varësisht nga përqindja e përfaqësimit në kuvend do të përfaqësohet edhe në komitet, vazhdon me entitetin e dytë që ka numrin më të madh të anëtarëve të kuvendit, e kështu me radhë, derisa të ndahen të gjitha vendet në komitet”

Bazuar në pretendimet e lartëshënuara Kuvendi i Komunës duhet të ndërmarr vendime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, ta rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarsitvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 12.03.2026 -VI-020-5/8
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimi 01 Nr.26 për plotësim ndryshimin e vendimit me Nr. 10 të datës 30.12.2025
I miratuar më datë: 27.02.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.03.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026, ka miratuar Vendimi 01 Nr.26 për plotësim ndryshimin e vendimit me Nr. 10 të datës 30.12.2025.

Vendimi 01 Nr.26 për plotësim ndryshimin e vendimit me Nr. 10 të datës 30.12.2025, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht nenin 52, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe me Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Ne nenin 52 paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale parashihet se: Komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në kuvendin e komunës.

Ndërsa neni 5 paragrafi 1 dhe 2 i Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, përcakton se " Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës. Entiteti politik më numrin më të madh të vendeve, varësisht nga përqindja e përfaqësimit në kuvend do të përfaqësohet edhe në komitet, vazhdon më entitetin e dytë që ka numrin më të madh të anëtarëve të kuvendit e kështu me radhë derisa të ndahen të gjitha vendet në komitet".

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Ferizajt duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme lidhur me këtë vlerësim.